

Statistikat afatshkurtra

Shërbimet - Tremujori II 2024


Tiranë, më 16 Shtator 2024: Treguesit tremujorë mbi shërbimet, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transport, Magazinim dhe Postë; Hotele; Bar-Restorante; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi, në tremujorin e dytë 2024, paraqiten si më poshtë:

Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Indekset e treguesve në aktivitetin Tregti, e cila përfshin tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, në tremujorin e dytë 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 3,8 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 10,8 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Tregti (%)



Për publikim 16/09/2024

Vijon

Transport, Magazinim dhe Postë

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Postë, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Detar, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e dytë 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 8,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 0,7 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 5,3 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Transport, Magazinim dhe Postë (%)




Hotele

Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e dytë 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 17,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 8,7 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 15,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Hotele (%)




Bar, Restorante

Indekset e treguesve në aktivitetin Bar-Restorante, në tremujorin e dytë 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 11,6 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 0,6 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 3,8 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Bar-Restorante (%)




Informacion dhe Komunikacion

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit, Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e dytë 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënie 4,4 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 8,5 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 7,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Fig. 5 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Informacion dhe Komunikacion (%)




Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike

Indekset e treguesve në aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike, në tremujorin e dytë 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 2,9 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 14,2 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Fig. 6 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Aktivitete Arkitekturore dhe Inxhinierike (%)




Agjenci udhëtimi

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e dytë 2024, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 7,2 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 6,7 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 15,2 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Fig. 7 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Agjenci udhëtimi (%)



Tab. 1 Indeksi i Shitjeve neto në volum, Shërbime (2021=100)

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.II 2024 (2021=100)	II.24/ II.23 (%)	Tr. II 2024 (2021=100)	II.24/ I.24 (%)
G	45+46 +47	Tregti	105,0	3,8	107,3	0,6
H	49-53	Transport dhe Magazinim*	127,7	8,1	125,3	9,0
I	55,1	Hotele	176,8	17,1	181,5	6,9
I	56	Bar-Restorante	124,8	11,6	130,6	6,4
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	107,3	-4,4	113,0	-0,1
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	90,3	2,9	96,8	2,8
N	79	Agjenci udhëtimi	246,5	7,2	253,9	4,4

Tab. 2 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, Shërbime (2021=100)

NVE Rev.2			Numri i të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr II 2024 (2021=100)	II.24/ II.23 (%)	Tr II 2024 (2021=100)	II.24/ II.23 (%)
G	45+46+47	Tregti	103,4	3,1	149,1	10,8
H	49-53	Transport dhe Magazinim	110,2	0,7	151,9	5,3
I	55,1	Hotele	145,4	8,7	212,3	15,1
I	56	Bar-Restorante	106,6	0,6	154,2	3,8
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikimi	152,0	8,5	230,7	7,1
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	119,6	1,1	164,6	14,2
N	79	Agjenci udhëtimi	156,7	6,7	235,3	15,2

Metodologjia

Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikave evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Shërbime si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i dytë 2024, do të llogariten me vit bazë 2021=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin referencë 2022, realizuar nga INSTAT.
- Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën Tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin Shërbimi Ushqimor (Bar- Restorante).

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Në Shërbime

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46), Tregti me pakicë(47)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele (55,1) dhe Bar-Restorante (56)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2021=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres, Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më katër.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjeve neto - Shitjet neto përfshijnë shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes shërbimeve të katërve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shitjeve neto - Objektiv i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime,

Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

Indeksi i Numrit të punësuarve - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.4. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecificimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori II 2024. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme, Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit , komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.